



**Begzad Baliu** (Makresh i Ultë - Gjilan, 1966): profesor universitar, albanolog, publicist, shkrimtar dhe editor. Profesor i rregullt në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit. Ligjërues në disa universitete, konferenca shkencore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare: Universiteti i Turunit “Nikolla Koperniku”; Universiteti i Shkupit “Kirili e Metodi”, Universiteti i Varshavës, Universiteti i Europës Juglindore dhe pothuajse në të gjitha universitetet publike shqiptare në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

Autor i shumë veprave studimore nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, historisë dhe kulturës shqiptare. Organizator dhe koordinator i shumë konferencave ndërkombëtare në institucionet universitare dhe shkencore të Prishtinës, Prizrenit, Shkupit, Tiranës, Korçës, Shkodrës, Varshavës, Turunit, Gjirokastrës dhe pjesëmarrës edhe në shumë konferenca të organizuara nga qendra të tjera ndërkombëtare. Kryeredaktor i revistës shkencore “Shenjëzat” dhe “Educologia”, Prishtinë; anëtar i redaksisë së revistës ndërkombëtare “Malësia”, Podgoricë; anëtar i redaksisë së kolanës universitare “Sociolinguistika shqiptare”; mentor dhe bashkëmentor i shumë projekteve, në mesin e të cilëve ai Universitetit të Varshavës “Kosova e pavarur në sytë e të rinjve të saj (shoqëria - kultura – politika)” dhe “Eposi në pesë shtete të Ballkanit”; Ambasador i Paqes (2009); dhei nominuar i Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë për Çmimin e vitit 2008 për veprën *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan* (2004).

Dy dekadat e fundit është besuar përgatitja e shumë veprave të autorëve dhe trashëgimisë albanologjike. Është kryesues i Këshillit për përgatitjen e veprave të Profesor Jup Kastratit dhe anëtar i Këshillit për botimin e veprave të Profesor Eqrem Çabejt. Ka përgatitur për botim veprat e Profesor Jup Kastratit, Profesor Shefki Sjediut, konferencave shkencore etj. Këto ditë pritet të nxjerr nga shtypi një vëllim me studime të panjohura të Profesor Shefki Sejdiut dhe të Profesor Eqrem Çabejt.

## **Vepra**

### **I. Në fushë të albanologjisë**

- *Gustav Majer dhe albanologjia*, Prishtinë, 2000; *Tiranë*, 2001
- *Vepra bibliografike e profesor Jup Kastratit*, Prishtinë, 2005
- *Semantika e fjalësit (Vepra albanologjike e Zenun Gjocajt)*, Prishtinë, 2009
- *Kërkime albanologjike*, Prishtinë, 2010
- *Referenca albanologjike*, Prishtinë, 2010
- *Hulumtime albanologjike*, Prishtinë, 2015

- *Testamenti shkencor i Profesor Jup Kastratit*, Prishtinë, 2016
- *Rrapi shekullor – Akademik Idriz Ajeti (bashk.)*, Prishtinë, 2016
- *Sprovë për një histori të albanologjisë*, Prishtinë, 2016
- *Studime për historinë e albanologjisë, sprovë për një histori të albanologjisë*, Shkup, 2018
- *Albanologji: Periudha, autorë, studime dhe dokumente*, Prishtinë, 2020

## **II. Në fushë të onomastikës dhe të leksikografisë**

- *Onomastika e Gallapit, (I)*, Prishtinë, 2016
- *Onomastika dhe dokumenti*, Prishtinë, 2016
- *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, Prishtinë, 2014
- *Onomastikë dhe identitet*, Prishtinë, 2012.
- *Onomastika e Kosovës - ndërmjet miteve dhe identiteteve*, Prishtinë, 2009
- *Regjistri i standardizuar i emërve të Kosovës (bashk.)*, Prishtinë, 2005
- *Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës*, Tiranë, 2006
- *Sprovë për një fjalor historik të shqipes*, Prishtinë, 2020 (në proces)
- *Political standardization of toponymy in the Western Balkans*, Lambert Academic Publishing (në process), 2020

## **III. Në fushë të bibliografisë**

- *Çabej 1* (Bibliografi e studimeve për veprën e Profesor Eqrem Çabejt në Kosovë), Prishtinë, 2006
- *Bibliografia përmbajtësore e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 2008
- *Mbi autorësinë e veprës “Bibliografia e Skënderbeut”*, Prishtinë, 2005

## **IV. Në fushë të studimit të letërsisë dhe të krijimtarisë letrare**

- *Struktura e vlerave përfaqësuese*, Prishtinë, 2014
- *Kujtesa letrare*, Prishtinë, 2013
- *Pesha e komunikimit (bashk.)*, Prishtinë, 2010
- *‘Dhembje e bukur’*, (bashk.), Prishtinë, 2012
- *Jup Kastrati për Kosovën (bashk.)*, Prishtinë, 2004
- *Vareni kryengritësin e shenjtëruar*, Prishtinë, 2010
- *Kafeneja ballkanike*, Prishtinë, 1996 (e përkthyer edhe në kroatisht, italisht dhe holandisht)
- *Grua e dashuruar*, Prishtinë, 1996
- *Flamuri vjen nga Kosova*, Prishtinë, 1994
- *Dëshmori i qiellit me pëllumba*, Prishtinë, 2016

- *Vjeshta e lutjeve*, Tiranë, 2016
- *Mbileximi i kujtesës historike*, Prishtinë, 2016
- *Gjaku i lirisë (1981-1995) I-IV*, Prishtinë, 1996/2000.

### **Tekste shkollore**

- *Gjuha shqipe, 10* (bashka.), Prishtinë, 2019
- *Gjuha shqipe, 11* (bashka.), Prishtinë, 2019